



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN**

Nr. 362 Prot.

Tiranë, më 28.09.2023

URDHËR

Nr. 118, dt. 28.09/2023

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË E
SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË 2023-2025”**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin Nr. 109, të Këshillit të Ministrave, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 516, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të Verpimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve”; Urdhër Nr. 80, datë 27.06.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë 2023 – 2025, bashkëlidhur këtij urdhëri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Xhiliola Bexheku



Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë, Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

PLANI I INTEGRITETIT
PËR AGJENCISË E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
2023-2025

TIRANË, 2023



PËRMBAJTJA

Deklarata e Integritetit Institucional	3
Lista e Shkurtesave.....	4
1. Procesi i Hartimit të Planit të Integritetit.....	5
1.1 Përshkrim i shkurtër për institucionin.....	5
1.2 Baza Ligjore	5
1.3 Ngritja e Grupit të Punës.....	5
1.4 Përkufizimi i "Integritetit"	6
1.5 Informacion i shkurtër mbi Planin e Integritetit	6
1.6 Plani i Integritetit i ASCAL-it dhe qasja metodologjike.....	6
2. Risqet dhe Faktorët e Risqeve.....	7
2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve	7
2.2 Veprimtaria brenda institucionit.....	7
- Drejtori i Përgjithshëm.....	7
- Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion.....	7
- Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë.....	7
- Sektori i Statistikave dhe Analizave.....	7
- Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin.....	8
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	8
3. Risqe të Përgjithshme	11
3.1 Risqet lidhur me konfliktin e interesit	11
3.2 Risqet lidhur me informimin	11
3.3 Risqet lidhur me transparencën.....	12
3.4 Risqet lidhur me etikën	12
3.5 Risqet lidhur me korrupsionin.....	12
Plani i Veprimit	13
Objektivat Strategjik 2023-2025	13
Plani i Veprimit	
Monitorimi	16



Deklarata e Integritetit Institucional

Përballja efektive me korrupsionin për Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe për përmbushjen e misionit.

ASCAL është i vetmi institucion në Republikën e Shqipërisë që kontrollon dhe vlerëson cilësinë në arsimin e lartë. Kjo, duke u mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë. ASCAL është i pavarur, i paanshëm dhe transparent në kryerjen e veprimtarisë së tij. ASCAL kryen procesin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu ASCAL kryen vlerësime analitike dhe krahasuese për IAL, programet dhe fushat e studimit. Pjese e veprimtarisë së ASCAL janë edhe vlerësimi periodik, çdo tre vjet, i cilësisë së mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë dhe monitorimi i vazhdueshëm i tij përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve, në përputhje me udhëzuesit e saj; Vlerësime tematike, analitike dhe krahasuese të institucioneve dhe/ose programeve të studimit, në funksion të politikave për arsimin e lartë, në mënyrë autonome ose me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Plani Integritetit përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të ASCAL dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për qytetarët.

Jemi të ndërgjegjshëm se, dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e publikut tek ne.



Lista e Shkurtesave

MD – Ministria e Drejtësisë

MAS- Ministria e Arsimit dhe Sportit

SNKK – Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit

ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

PBA – Projekt buxheti afatmesëm

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

IAL –Institucionet e Arsimit të Lartë

BA- Bordi i Akreditimit

MVRI- Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

PI- Plan Integriteti



1. Procesi i Hartimit të Planit të Integritetit

1.1 Përshkrim i shkurtër për institucionin

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar dhe rrjedh nga riorganizimi i Agjencisë Publike të Arsimit të Lartë e cila është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 01.07.1999. ASCAL funksionin mbi bazën e legjislacionit të sipër përmendur si edhe në bazë të akteve ligjore e nën ligjore të cilat i takojnë fushës së veprimtimit të ASCAL.

Kuadri normativ si më sipër, përcakton dhe misionin, objektivat dhe detyrat e ASCAL-it, si më poshtë:

Misioni i Agjencisë së Sigurisë së Cilësisë në Arsimin e Lartë është sigurimin i cilësisë në arsimin e lartë, me qëllim rritjen e performancës së veprimtarisë të këtyre institucioneve, nëpërmjetë mekanizmeve të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së institucionit dhe të programeve të ofruara.

1.2 Baza Ligjore

- Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"
- Ligji Nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë", i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë";
- Vendimi nr. 516, datë 1.7.2020 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të Verpimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve";
- Urdhri Nr. 334, datë 7.10.2020 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore";
- Vendim Nr. 72, datë 10.09.2022 i Bordit të Akreditimit për "Miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë".

1.3 Ngritja e Grupit të Punës

Në vijim të shkresës nr. 2905/7 prot., datë 19.05.2023, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtori i Përgjithshëm, i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, me Urdhrin Nr. 80 datë 27.06.2023, ka ngritur grupin e punës për hartimin e Planit të Integritetit. Grupi i punës kreu vlerësimin fillestar të integritetit, dhe grumbulloi dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e një plani integriteti. Në vijim, ai shqyrtoi dhe analizoi



dokumentacionin e mbledhur lidhur me vlerësimin e ekspozimit dhe rezistencën e institucionit ndaj rreziqeve.

U identifikuan dhe u analizuan risqet dhe faktorët e risqeve, intensitetit e risqeve të identifikuar dhe renditja e tyre, si dhe u caktuan masat për trajtimin e risqeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e integritetit, si dhe prioritizimi e masave të propozuara.

Gjithashtu, përgatiti planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integriteti, të ASCAL-it.

1.4 Përkufizimi i “Integritetit”

Integriteti konsiston në përmbushjen e disa karakteristikave për një qeverisje të përgjegjshme dhe përbën një parakusht për ligjshmërinë e veprimeve të qeverisë, në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

Disa nga format e shkeljes së integritetit janë:

- Korrupsioni;
- Përvetësimi, shpërdorimi, devijimi i fondeve publike;
- Trajtimi i qytetarëve në mënyrë të pabarabartë ose të padrejtë;
- Kërkesat dhe procedurat e tepërta administrative;
- Mosrespektimi i procedurave/mosrespektimi i kërkesave ligjore;
- Mungesa e profesionalizmit gjatë ushtrimit të detyrave;
- Neglizhenca.

Risku i integritetit përbën efektin e pasigurisë për objektivat organizative të institucionit, të shkaktuar nga korrupsioni dhe shkeljet e integritetit, si dhe lidhet me mundësinë e përditshme të ndodhjes së një ngjarjeje me ndikim në integritetin e institucionit.

1.5 Informacion i shkurtër mbi Planin e Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operativ, i cili i shërben institucionit për identifikimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve, që çenojnë integritetin e institucionit, zyrtarëve dhe nëpunësve publikë. Pra, shërben si një dokument pune, ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

Në kuadër të reformave të administratës publike, rezultojnë të rëndësishme forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion. Qëllimi i vlerësimit të riskut është identifikimi i risqeve “të sjelljes” brenda institucionit, që kompromenton aftësinë e tij për të kryer funksionin e shërbimit publik, në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.

Plani i Integritetit përfshin përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, forcimin e rezistencës institucionale ndaj çënimeve të integritetit, si dhe planifikimin e menaxhimit të riskut të integritetit.

1.6 Plani i Integritetit i ASCAL-it dhe qasja metodologjike

Plani i Integritetit i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë u hartua gjatë periudhës Qershor — Shtator 2023. Ky plan u hartua duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore.



Në kuadër të hartimit të këtij dokumenti, si dhe për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit u përdorën këto metoda:

- **metoda cilësore** nëpërmjet takimeve me punonjësit e institucionit, analizës së kuadrit rregullator të brendshëm;
- **metoda sasore** e mbledhjes së të gjithë kuadrit (akteve) rregullator të organizimit dhe funksionimit të ASCAL-it.

Hartimi i dokumentit është kryer nga Grupi i Punës. Gjatë këtij procesi, janë angazhuar dhe kanë kontribuar të gjitha strukturat e brendshme të ASCAL-it, për aq sa mbulon fusha e tyre e përgjegjësisë.

2. Risqet dhe Faktorët e Risqeve

2.1 Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve apo ngjarjeve të shkeljes së integritetit, është trajtuar dhe harmonizuar kontributi i strukturave të ASCAL-it, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, duke u përqëndruar më së shumti tek identifikimi i faktorëve, burimeve, ndikimit dhe shkaktarëve. Gjithashtu, është mbajtur në konsideratë vlerësimi i risqeve, për të kuptuar mundësinë e ndodhjes së ngjarjeve të papërshtatshme.

Gjatë kësaj faze, Grupi i Punës i kushtoi vëmendje aspekteve ligjore dhe rregullatore të institucionit, duke u bazuar në çështje të tilla si analiza, bashkëbisedime, mbledhje informacionesh dhe koordinime.

2.2 Veprimtaria brenda institucionit

Struktura organizative dhe organika e ASCAL-it është miratuar me Urdhërin nr. 20 datë 26.01.2021, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë". Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë drejtohet nga drejtori, i cili është titullari i institucionit dhe përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët. Ai organizon dhe drejton gjithë veprimtarinë e institucionit. Drejtori i ASCAL emërohet, lirohet/shkarkohet nga detyra me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, me urdhër të Kryeministrit.

Struktura e ASCAL-it (gjithsej 19 punonjës) është ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

- **Drejtori i Përgjithshëm.**
- **Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion**
- **Spektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë:**
 - Përgjegjës Spektori (1 punonjës)
 - Specialist (6 punonjës)
- **Spektori i Statistikave dhe Analizave**
 - Përgjegjës Spektori (1 punonjës)
 - Specialist (3 punonjës)



- **Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin**
 - Përgjegjes Sektori
 - Specialist Jurist
 - Specialist
- **Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**
 - Përgjegjes Sektori
 - Specialist
 - Arkiv-Protokollist

Ky seksion i Planit të Integritetit i dedikohet identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit të risqeve, për drejtorinë e ASCAL-it, si dhe për sektorët e sipërcituar.

- **Drejtori i Përgjithshëm**

Drejtori është figura qendrore e Agejncisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe autoriteti drejtues i saj. Detyrat kryesore të tij lidhen me drejtimin e të gjithë aktivitetit të Agjencisë duke e përfaqësuar atë brenda dhe jashtë vendit, duke mbajtur marrëdhënieve zyrtare me ministrinë përgjegjëse për arsimin, Bordin e Akreditimit, institucionet e arsimit të lartë si dhe institucionet homologe.

- **Koordinatori i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion**

Në strukturën e ASCAL bazuar në Vendimin Nr. 618, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave për "Krijimin, Organizimin e Funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit", është bërë pjesë dhe koordinatori i rrjetit të koordinatorëve antikorrupsion, i cili jep aksesin e drejtpërdrejtë çdo qytetari/subjekti që ka një interes të ligjshëm për të adresuar ankesat/denoncimet që lidhen specifikuisht me rastet korruptive dhe praktikatat abuzive nga punonjësit e ASCAL.

- **Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë**

Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë kryen veprimtarinë e saj në funksion të drejtimit, koordinimit dhe ndjekjes deri në përfundimin e tij, të proceseve të vlerësimit të institucioneve dhe programeve të studimit, në proces akreditimi. Ky sektor mban komunikim institucional me Koordinatorët Institucionale të IAL-ve për mbarrëvajtjen e proceseve dhe procedurave, për transparencën me to.

Nga vlerësimi i kryer, nuk janë identifikuar risqe për këtë strukturë. Megjithatë referuar natyrës së punës dhe veprimtarisë që ushtrojnë, rekomandohet që:

Për sa i përket koordinimit dhe drejtimit të gjithë procesit të vlerësimit, vlerësohet se nuk ka një risk të drejtpërdrejtë gjatë ushtrimit të funksioneve nga nënpunësit, gjithsesi rekomandohet që të tregohet më shumë kujdes për ndjekjen e procedurave në përputhshmëri me agjendën e vlerësimit, për të respektuar afatet kohore, si dhe të kujdesemi që të gjithë hapat e procedurës të jenë transparente, me qëllim sigurimin e një procesi cilësor, objektiv dhe transparent.

- **Sektori i Statistikave dhe Analizave**



Sektori i Statistikave dhe Analizave kryen veprimtarinë e saj në funksion të administrimit të të dhënave elektronike që disponon ASCAL dhe BA për IAL-të, për proceset dhe procedurat që zhvillohen nga ASCAL, duke u siguruar për përditësimin e të dhënave elektronike nga institucionet e arsimit të lartë. Ky sektor merr masa për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, realizimin, koordinimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore në kuadër të Sondazhit Kombëtar të Studentëve. Gjithashtu ky sektor është përgjegjës edhe për verifikimin praraprak të ligjshmërisë të insitucioneve apo programeve të studimit në kuadër të aplikimit për akreditim.

Nga vlerësimi i kryer, nuk janë identifikuar risqe për këtë strukturë. Megjithatë referuar natyrës së punës dhe veprimtarisë që ushtrojnë, rekomandohet që:

Për sa i përket grumbullimit të të dhënave statistikore, verifikimit praraprak të aplikimeve në kuadër të akreditimit të institucioneve dhe programeve të studimi dhe botimit të raporteve periodike, sërisht vlerësohet se nuk ka një risk të drejtpërdrejtë gjatë ushtrimit të funksioneve nga nëpunësit, megjithatë rekomandohet që të tregohet vëmendje gjatë grumbullimit të të dhënave, me qëllim sigurimin e saktësisë së të dhënave.

- Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin

Bordi i Akreditimit është një organ kombëtar kolegjal i pavarur në veprimtarinë e tij i emëruar me urdhër të Kryeministrit Nr. 63, datë 27.07.2021, që siguron cilësinë e jashtme të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, nëpërmjet vendimeve për akreditimin dhe monitorimin e ruajtjes së standardeve të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike në Republikën e Shqipërisë. Bordi i Akreditimit përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 3 deri në 5 prej tyre janë anëtarë të huaj. Anëtarët e Bordit të Akreditimit duhet të kenë të paktën një përvojë 10-vjeçare në institucione akademike dhe kërkimore, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit. Ata duhet të kenë gradë shkencore, titull akademik, ose të kenë të paktën pesë vite përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Anëtarët dhe kryetari i Bordit emërohen dhe shkarkohen nga kryeministri me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin.

Nga analiza e kryer, nuk rezultojnë risqe të lidhura me funksionet që kryen Sektori i Marrëdhënieve me Bordin e Akreditimit dhe Ndërkombëtarizimin, për të cilin është bërë një trajtim i detajuar në vijim.

Në lidhje me marrjen e vendimeve përfundimtare për akreditimin e një programi dhe/ose institucioni të caktuar Bordi i Akreditimit argumenton dhe mbështet vendimet e tij për akreditimin, duke marrë parasysh të dhënat dhe evidencat e mëposhtme: kontekstin ligjor të institucionit, të dhënat kryesore për institucionin dhe programet e tij, raportet e vetëvlerësimit dhe evidencat mbështetëse, raportin e vlerësimit nga grupi i vlerësimit të jashtëm, raportimin verbal eventual nga ana e anëtarëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në mbledhjen e Bordit të Akreditimit, të dhënat për procedurat e vlerësimit, rezultatet dhe përfundimet nga vlerësime/akreditime të mëparshme, informacionin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vlerësimeve/akreditimeve të mëparshme dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme.



Në lidhje me zhvillimin e mbledhjeve punonjësit e këtij sektori marrin masat mbi organizimin/ menaxhimin e mbledhjeve, në drejtim të mbajtjes së procesverbalit, menaxhimit të drejtimit digital të saj, si dhe organizimin e mbledhjeve online. Duke qenë se ky sektor merr pjesë në çdo mbledhje të BA kujdeset të ruaj me korrektësi dhe konfidencialitet çdo informacion / të dhëna të diskutuara gjatë mbledhjes.

Në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të BA, specialist juristi pranë këtij sektori kujdeset që aktet e brendshme rregullatore të ASCAL dhe BA të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke njoftuar të gjithë punonjësit e Agjencisë si dhe anëtarët e BA rreth përditësimeve ligjore që kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së BA dhe ASCAL-it.

- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Misioni i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është të mbështesë në kohë dhe me efikasitet zbatimin dhe monitorimin e proceseve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit sipas legjislacionit përkatës, në mënyrë që veprimtaria të kryhet në përputhje me buxhetin e akorduar dhe objektivin e performancës buxhetore, miradministrimin financiar të fondeve buxhetore të miratuara dhe burimeve të tjera financiare të ASCAL-it, evidentimi dhe shpërndarja e dokumentacionit të institucionit në kohë dhe afate, si dhe miradministrimin e shërbimeve të përgjithshme të funksionimit të administratës.

Nga analiza e kryer, nuk rezultojnë risqe të lidhura me funksionet që kryen Sektori, për të cilin është bërë një trajtim i detajuar në vijim.

Në lidhje me hartimin e PBA për planifikimin e fondeve buxhetore të nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe objektivave të programuara për ASCAL-in, nëpunësit do të mbajnë në konsideratë zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Burimet njerëzore të ASCAL-it menaxhohen nga Përgjegjësi i Sektorit, i cili ndjek rekrutimet dhe organizimin strukturor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm organizativ dhe funksional. Për nëpunësin e angazhuar me këto detyra, konsiderohet mjaft e rëndësishme ndjekja dhe plotësimi i kërkesave ligjore të dosjeve personale të nëpunësve, duke kërkuar në mënyrë periodike pasqyrimi në dosje i vlerësimit të punës së tyre nga secili përgjegjës sektori.

Gjithashtu, nëpunësi që mbulon këtë fushë, bën përpjekje të vazhdueshme në lidhje me:

- plotësimin e formularit/aktit të deklarimit të konfliktit të interesit dhe të përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kohën e punësimit të çdo nëpunësi;
- njohjen e Rregullores së Brendshme nga të gjithë nëpunësit;
- ruajtjen e integritetit të nëpunësve të lidhur drejtëpërdrejtë me burimet njerëzore;
- ruajtjen e parimit bazë ligjor të konfliktit të interesit, me qëllim parandalimin e tij në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të ndryshme, në mënyrë objektive dhe të paanshme, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me *administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit* që hyn në institucion apo që shpërndahet sipas rastit brenda ASCAL-it, konstatohet se në mënyrë sistematike



menaxhohen regjistra, në të cilat reflektohet protokollimi dhe veprimtaria e institucionit, në drejtim të shkresave hyrëse dhe dalëse, si dhe krijimi i fondit arkivor.

3. Riske të Përgjithshme

Gjatë hartimit të planit të integritetit, janë identifikuar disa risqe, të cila mund të çenojnë integritetin e cilitdo prej nëpunësve. Kështu, janë cilësuar risqet e përgjithshme që vijnë nga rastet e konfliktit të interesit, rastet e shkeljes së rregullave të brendshme, rastet e shkeljes së normave të transparencës, si dhe të drejtës të informimit.

3.1 Risqet lidhur me konfliktin e interesit

Për parandalimin e konfliktit të interesit, vihet re se nuk ka një strukturë të veçantë, por prezumohet se legjislacioni njihet nga ana e nëpunësve publikë. Fillimisht bëhet me dije se, burimet njerëzore të institucionit i kërkojnë çdo nëpunësi me kontratë, të punësuar rishtazi, që të njihet dhe nënshkruajë aktin zyrtar në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit. Kjo i shërben periudhës së punësimit të nëpunësit, për zbatimin në mënyrën e duhur të legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit, me qëllim ruajtjen e integritetit të nëpunësve. Në vijim të kësaj procedure, konstatohet se një autorizim i tillë ka vlerë në çdo kohë, por vetëm për ato të dhëna të interesave private të nëpunësit, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike, në kohën e ushtrimit të saj.

Për sa i përket procedurave të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e konkurrenive, prokurimeve, tenderave, apo procedurave të ngjashme, në të cilat nëpunësi ka rol vendimmarrës apo të drejtë vote, konstatohet se ky i fundit njihet me legjislacionin në fuqi dhe merr masat e duhura për të vepruar në përputhje me ligjin. Për këtë, rekomandohet që të zbatohet legjislacioni për ndalimin e konfliktit të interesit, edhe pse deri më tani nuk janë evidentuar risqe integriteti.

Anëtarët e Bordit të Akreditimit duhet të deklarojnë paraprakisht në rast se ndodhen në konflikt interesi. Në rast konflikti interesi, anëtari i Bordit të Akreditimit nuk përfshihet gjatë procesit të adresimit të rastit në fjalë. Anëtarit nuk i vihet në dispozicion dokumentacioni apo raportet për procedurën specifike. Ai/ajo largohet nga salla e mbledhjes gjatë diskutimeve dhe gjatë votimeve për marrjen e vendimeve që i përkasin institucionit në fjalë.

3.2 Risqet lidhur me informimin

Në lidhje me fushën e veprimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, konstatohet se nëpunësit, pjesë e sektorëve të ASCAL-it janë njohur me të dhe nuk kanë problematika për zbatimin e duhur të ligjit. Megjithatë, duke patur parasysh ristrukturimet apo rastet e ndërrimit të personelit për shkak të transferimeve, lëvizjes paralele apo pranimit në shërbim civil, rekomandohet që t'iu bëhet i njohur legjislacioni në fuqi për informimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.



Disa nga risqet e identifikuara evidentuar në këtë fushë janë:

- Aksesimi në informacionin e klasifikuar i personave të pacertifikuar;
- Lëshimi i informatave konfidenciale tek personat e paautorizuar;
- Kushte të papërshtatshme të sigurisë në ambientet ku administrohet dokumentacioni.

3.3 Risqet lidhur me transparencën

Parimi i transparencës është parim bazë në veprimtarinë e administratës publike, për publikimin e informacionit procedural dhe përmbajtësor të shërbimeve publike në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë duke respektuar kufizimet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Për sa i përket transparencës, ASCAL-i disponon faqe zyrtare në web ku janë të bëra publike të gjithë informacionet e nevojshme mbi funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e kësaj agjencie.

Gjithashtu, nëpunësi në cilësinë e koordinatorit për të drejtën e informimit merr masat për përditësimin dhe mbajtjen e programit të transparencës.

3.4 Risqet lidhur me etikën

Referuar Rregullores së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, për punonjësit janë përcaktuar disa norma të detyrueshme sjellje, respektimi i të cilave lidhet me orarin zyrtar, përdorimin me efikasitet të kohës së punës dhe burime materiale, kryerjen e lejes vjetore brenda afateve të kërkuara, shërbimet e kryera jashtë qytetit apo vendit, komunikimin e brendshëm me rrjet elektronik etj.

Të gjitha cënimet që mund të shkaktohen nga nëpunësit ndaj normave të sjelljes trajtohen në përputhje me Rregulloren e Brendshme, Kodin e Punës, si dhe Ligjin 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Në këto kushte, nuk vlerësohen risqe të përgjithshme.

3.5 Risqet lidhur me korrupsionin

Në zbatim të ligjit nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", rekomandohet që çdo nëpunësi t'i bëhet e njohur se nuk duhet të kërkojë ose të pranojë dhurata, favore, ose çfarëdo përfitimi tjetër, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare. Gjithashtu nuk duhet të pranohen në çfarëdo lloji mënyre apo forme, direkte apo indirekte, dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale, negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e nëpunësit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për nëpunësin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës.



Plani i Veprimit

Objektivat Strategjik 2023-2025

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, ASCAL-i ka vendosur tre objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2023-2025, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara.

Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë 2023-2025 të Planit të Integritetit, janë:

- Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit;
- Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe proceseve të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit;
- Garantimi i transparencës me publikun.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

1. Kuadri i brendshëm rregullator

Objektivi: Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit							
Aktiviteti	Output	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioritet	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Ndjekja e përmbushjes së objektivave në veprimtarinë institucionale	Miratimi i një nënakti strategjik	6M1 2024	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	I lartë	Mundësi për performancë të ulët në realizimin e tagrave dhe mos maksimalizim i burimeve njerëzore të institucionit	Miratimi i një plan veprimi	Burimet njerëzore të ASCAL, pa kosto shtesë financiare
Përcaktimi i detajuar i Kodit të Etikës	Miratimi i një nënakti	6M1 2024	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	I lartë	Mundësi për performancë të ulët në realizimin e tagrave dhe mos maksimalizim i burimeve njerëzore të institucionit	Miratimi i Kodit të Etikës	Burimet njerëzore të institucionit, pa kosto shtesë financiare



2. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe proceseve të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit.

Objektivi: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në Agjenci përmes fuqizimit të një administrate profesionale dhe efikase							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Kualifikimi i mëtejshëm e punonjësve të institucionit	Rritja e eficiencës në punë.	6M1 2024	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	I lartë	Mbingarkesë në përmbushjen e detyrave funksionale nga punonjësit dhe mundësi për performancë të ulët të institucionit	Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime apo konferenca në përputhje me pozicionin e punës.	Burimet njerëzore të institucionit me kosto shtesë
Asistentencë për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të brendshëm të menaxhimit të ASCAL	Sistemi i Menaxhimit të Brendshëm shumë funksional	6M1 2024	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	I lartë	Pamundësia për të adresuar problematikat në lidhje me shërbimet e ofruara nga ASCAL	Ndërveprimi me donatorët për garantimin e mbështetjes financiare	Burimet njerëzore të institucionit, me koston shtesë dhe donatorë

3. Transparenca me publikun

Objektivi: Forcimi i një sistemi funksional të integritetit në Agjenci përmes fuqizimit të një administrate profesionale dhe efikase							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Asistentencë teknike për përditësimin dhe përmirësimin e faqes në internet.	Faqe sa më e plotë me informacione dhe lehtësisht e aksesueshme e kuptueshme nga publikun	6M1 2024	Sektori i Statistikave dhe Analizave	I lartë	Pamundësia për të adresuar problematikat teknike që mund të vijnë në funksionimin e faqes	Ndërveprimi me donatorët për garantimin e mbështetjes financiare	Burimet njerëzore të institucionit dhe donatorë



Në përfundim të hartimit të Planit të Integritetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të figurës së nëpunësit, ruajtjen e profesionalizmit, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi në fushat që operon agjensia përcaktohet se nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë duhet të konsiderojnë që:

1. Të karakterizohen nga ndershmëria dhe përkushtimi në kryerjen e detyrave, duke zbatuar me rreptësi rregullat që normojnë disiplinën në punë;
2. Të ruajnë reputacionin, dinjitetin si dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi që mund të çënojë emrin e mirë të tyre apo të institucionit, duke ruajtur të pastër figurën e tyre morale dhe duke shmangur sjellje apo veprime, të cilat çënojnë autoritetin dhe imazhin e tyre para opinionit publik;
3. Të reflektojnë standarde të larta të integritetit profesional e personal në ushtrimin e detyrave të tyre, për të siguruar funksionimin sa më transparent, të ndershëm, të drejtë dhe të përgjegjshëm, të fushës së përgjegjësisë së institucionit;
4. Të garantojnë mbrojtjen e interesit publik në gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të kompromentojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut;
5. Të shmangin sjellje të paqarta dhe të dyshimta apo çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, kombësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose për çdo shkak tjetër.
6. Të njihen personalisht me përshkrimin e punës që do të kryejnë sipas pozicionit, duke iu përmbajtur përcaktimeve të tij;
7. Të ndërveprojnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin me frymën e bashkëpunimit, respektit reciprok, komunikimit korrekt, sjelljes së përshtatshme etj.
8. Të njihen me përditësimet ligjore apo administrative të legjislacionit në fuqi të cilat lidhen me funksionin e agjencisë.
9. Të mbajnë në konsideratë parimet bazë të veprimtarisë së institucionit;
10. Të mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve gjatë ushtrimit të detyrës;
11. Të respektojnë dispozitat ligjore që rregullojnë konfidencialitetin, informimin publik, konsultimin publik dhe transparencën;
12. Të deklarojnë çdo rast të konfliktit të interesit;
13. Të mos kërkojnë apo të mos pranojnë dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
14. Të mbajnë në konsideratë forcimin e integritetit institucional, si dhe forcimin e rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.



Monitorimi

Monitorimi i ndjekjes së Planit të Integritetit apo zbatimit të rekomandimeve të dhëna do të kryhet periodikisht dhe përfshin aktivitete nga ana e nëpunësit të ngarkuar me këtë qëllim. Procesi synon të përcaktojë nëse është e nevojshme marrja e masave, nëse janë evidentuar ndryshime të risqeve, si dhe nëse ka kërkesa për rishikim.

Për proceset e detajuara të monitorimit, raportimit, konstatimit apo çështjeve të lidhura me to, do të angazhohet një ose disa nëpunës, të caktuar nga titullari, të cilët do të kenë të drejtë të veprojnë drejtpërdrejtë, të kërkojnë ngritjen e një grupi pune ose të kërkojnë asistencën e Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Të gjitha aktivitetet që ndërmerren në kuadër të Planit të Integritetit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë do t'i njoftohen titullarit.

